



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.31/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada-Glllogjani dhe Faton Ademi anëtarë, me zyrtares ligjore, Robertina Lekaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR-AL, dega në Gjilan, për shkak të vendosjes së posterit në objekte publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 05.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Prishtinë, kështu që Koalicioni LDK-AKR-AL, dega në Gjilan, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,300.00 (njëmijetreqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimin të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 02.06.2017, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur një parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke i bashkangjitur si dëshmi fotografimin e printuar nga vendi i ngjarjes. Parashtruesi i ankesës potencon se me datën 01.06.2017, në rrugën kryesore në qytetin e Gjilanit, në afërsi të Teatrit të Qytetit, monitoruesi i tyre ka hasur në postere të kandidatëve për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga Koalicioni LDK-AKR-AL, të ngjitur objekte publike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33, paragrafi 1, pika b, e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073 dhe konsideron se Koalicioni PDK-AAK-NISMA, ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur poster të kandidatëve për deputet në hapësirë publike.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar për rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë Koalicioni LDK-AKR-AL, të datës 03.06.2017, ka theksuar se pas pranimit të Ankesës Anr.31/2017 kanë ndërmarrë veprime përmirësuese duke evituar shkeljen e pretenduar në ankesë. Dhe si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre kanë bashkangjitur foto të vendeve ku janë larguar posterat.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterit i kandidatit për deputet nga radhët e Koalicionit LDK-AKR-AL, është i vendosur në objekt publik, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton se: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase koalicioni LDK-AKR-AL, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe faktin se posterit i kandidatit për deputet nga ky koalicion është vendosur në objekt publik. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që Koalicioni LDK-AKR-AL, ia dha mundësinë për tu përgjigjur dhe ka bërë përmisimin e shkeljes ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se kanë ndërmarrë veprime për të tërhequr posterat në vendin e palejuar.

Paneli e urdhëroi koalicionin LDK-AKR-AL, për ta përmirësuar shkeljen e kodit të mirësjelljes për subjektet politike, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime e duhura për evitimin e shkeljes duke e larguar menjëherë posterin nga vendi ku ka ndodhur shkelja, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar në ndodhur shkelja, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga ana e koalicionit LDK-AKR-AL, është shkelur neni 33, pika (b), të LZP-së, pasi që posteri i kandidatit për deputet nga koalicioni LDK-AKR-AL, nga provat e ofruara shihet qartë se është i vendosur në rrugën kryesore në qytetin e Gjilanit, në afërsi të Teatrit të Qytetit-objekt publike si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të koalicionit në fjalë që ka ndërmarruë për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 31/2017 më datën 05.06.2017.

Kryesuesi i Panelit

Zyhydi Haziri



Këshilla Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.